

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të paraqitur nga **Mondstein 511. GmbH**, me seli të regjistruar në Inselkammerstrasse 10, 82008 Unterhaching, Mynih, Gjermani, përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 28.03.2024, miratoi këtë

AKTVENDIM

Konstatohet se përqendrimi me të cilin shoqëria **Mondstein 511. GmbH**, me seli të regjistruar në Inselkammerstrasse 10, 82008 Unterhaching, Mynih, Gjermani ka fituar kontrollin mbi **alfer-aluminium GmbH**, me seli të regjistruar në Industriastrasse 7, 79793 Wutöschingen, Gjermani, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimin në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 05.03.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i është dorëzuar njoftim për përqendrim nga **Mondstein 511. GmbH**, me seli të regjistruar në Inselkammerstrasse 10, 82008 Unterhaching, Mynih, Gjermani, me të cilin **Mondstein 511. GmbH** ka fituar kontrollin mbi **alfer-aluminium GmbH**, me seli të regjistruar në Industriastrasse 7, 79793 Wutöschingen, Gjermani. Kontrolli fitohet përmes futjes së kapitalit bazë në procesin e ristrukturimit gjatë falimentimit.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Mondstein 511. GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në maj 2023 si një shoqëri me qëllim të veçantë, pa histori të shitjeve/aktiviteteve të realizuara ndërkohë.

Mondstein është në pronësi të SOL-Drei EuVECA GmbH & Co KG ("**SOL-Drei**"), një fond i kapitalit privat. SOL-Drei EuVECA GmbH & Co KG është gjenerata e tretë e fondeve të SOL Capital Management që investojnë në kthesa në biznesin e kompanive, ndarje komplekse dhe situata të tjera të veçanta në rajonin DACH (Gjermani, Austri dhe Zvicër).

Mondstein është nën kontrollin përfundimtar dhe menaxhohet nga SOL Capital Management GmbH, me adresë të regjistruar në Mulwaldplatz 3/Top 9, 1040 Vjenë, Austri.

SOL Capital Management GmbH me fondet e saj ofron mbështetje për shoqëritë përmes zgjidhjeve për pasardhësit, ristrukturim dhe zhvillim të qëndrueshëm, duke siguruar fonde për kapital bazë dhe ekspertizë për ristrukturimin për kthesa dhe zhvillimin e shoqërive me qëllim të realizimit të kthimeve tërheqëse për investitorët. Që nga viti 2000, ekipi menaxhues i SOL Capital Management GmbH është aktiv në Austri, Gjermani dhe Zvicër.

Para zbatimit të Transaksionit, SOL Capital Management GmbH nuk ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur lokale (direkte ose indirekte).

alfer-aluminium GmbH ka seli në Gjermani (Wutöschingen) dhe zhvillon, prodhon dhe shet profile dhe gjysmë-produkte nga alumini, çeliku i pandryshkshëm dhe plastika kryesisht në Evropë. Alfer prodhon në selinë e saj në Wutöschingen dhe në një fabrikë prodhimi në Maqedoninë e Veriut. Shitja kryhet nga Gjermania, por edhe përmes shoqërive të shitjes në Francë, Itali dhe Austri.

Alfer ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë të saj të varur në pronësi të plotë FERAL Mehanika SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Pero Nakov nr. 144, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. FERAL Mehanika SHPKNJP Shkup prodhon një gamë të gjerë produktesh, si:

- Vegla: gjysmë-produkte, shufra me filetim metrik, fletë etj.;
- Materiale ndërtimi: profile për ndërtim të thatë, plintuse dhe profile për vendosjen e mbulimeve të dyshemesë si parket, laminat, pllaka dhe PVC; dhe
- Rregullim dhe magazinim: çengela, shina etj.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска